

5 prill 2021

Përshëndetje familje,

Të martën më 6 prill, qarku i shkollës do të hapë procesin e përzgjedhjes së modelit mësimor të fazës II, duke u dhënë mundësi të gjithë studentëve e klasave 3-5 dhe studentëve me nevoja të veçanta të klasave 6-8 të zgjedhin modelin mësimor hibrid në këtë vit shkollor. Anketa për përzgjedhjen mbyllet të martën më 13 prill.

Familjet e fazës II do të kenë mundësi të zgjedhin mes modelit mësimor hibrid dhe modelit mësimor 100% dixhital - pra modelin që u shërben më së miri nevojave të fëmijës dhe familjes suaj. Nëse zgjidhni modelin mësimor hibrid, fëmija do të kalojë në një program mësimor të përzier çdo javë, ku përfshihet si modeli personal, ashtu edhe ai dixhital, duke filluar nga dita e hënë, më 26 prill 2021. Këto programe kanë si synim të pakësojnë numrin e studentëve që shkojnë çdo ditë në shkollë dhe për të ruajtur distancimin social në të gjitha hapësirat e shkollës gjatë ditës.

Ju nxit që të shihni këto video: [Safe Return to School](#) dhe [Clean and Healthy Schools](#), dhe të vizitoni [philasd.org/aes](https://philasd.org/aes) për të mësuar më shumë rreth masave të shumta të sigurisë që kemi marrë për të mbrojtur shëndetin dhe mirëqenien e të gjithëve në shkollë. Nëse ende keni pyetje, mund të telefononi linjën tonë për familjet anglishtfolëse në 215-400-5300, nga e hëna në të premte, nga ora 8 e mëngjesit - 4:30 të pasdites. Linja telefonike në gjuhë të tjera mund të gjenden [këtu](#).

Sigurohuni që të kontrolloni email-in tuaj **të martën, më prill 6**, për të marrë linkun në lidhje me anketën për përzgjedhjen e modelit mësimor. Email-i do të vijë nga portal-notification@philasd.org dhe te rreshti i subjektit do të thuhet "School District of Philadelphia - Fully Digital vs. Hybrid Learning Model Selection". Nëse nuk ju vjen ky email, kontrolloni më parë dosjen e email-ëve "junk" ose "spam". Gjithashtu mund të telefononi direkt shkollën e fëmijës suaj për t'u regjistruar për mësimin hibrid. Nëse nuk përgjigjeni deri më datën 13 prill, fëmija do të qëndrojë te mësimi dixhital 100%. Familjet që zgjedhin modelin hibrid do të kontaktohen nga shkolla e fëmijës së tyre para datës 19 prill për hapat e radhës. Si gjithnjë, familjet që zgjedhin modelin mësimor hibrid, mund të kthehen te mësimi dixhital 100% në çfarëdo kohe.

Faleminderit për bashkëpunimin tuaj ndërsa përpiqemi fort për të plotësuar nevojat e vazhdueshme të fëmijës suaj në arsim.

Me respekt,



**Office of Communications**

Suite 301  
440 North Broad Street  
Philadelphia, PA 19130

The SDP Communications Team